



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12

**Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim
Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 19 qershor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me
Juridiksionin**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiq

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Edwards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 95(2)(f) dhe 97 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi pjesërisht aktakuzën kundër Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit (bashkërisht “të akuzuarit”) për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe rendit publik, konkretisht për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe/ose mosbindje ndaj gjykatës (“Vendimi i Konfirmimit”).²

2. Më 12 shkurt 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) apeloj Vendimin e Konfirmimit,³ me autorizim të Gjykatës së Procedurës Paraprake,⁴ dhe më 3 prill 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendimin mbi apelin e ZPS-së dhe i ktheu Gjykatës së Procedurës Paraprake një aspekt për shqyrtim të mëtejshëm.⁵

¹ KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, [Decision Assigning a Pre-Trial Judge](#) (Vendim për Caktimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake), 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial, para. 313. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 12 shkurt 2025, [F00036/RED](#).

³ KSC-BC-2023-12, IA002/F00002, Prokurorja e Specializuar, *Apel i Prokurorisë kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës (F00036)*, 12 shkurt 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-2 publike. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u dorëzua më 14 shkurt 2025, IA002/F00002/RED.

⁴ KSC-BC-2023-12, F00149, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Specialist Prosecutor's Request for Leave to Appeal the "Decision on the Confirmation of the Indictment"](#) (Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Leje për Apelin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës), 30 janar 2025, publik.

⁵ KSC-BC-2023-12, IA002/F00012, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 3 prill 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [IA002/F00012/RED](#).

3. Më 14 prill 2025, pas vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ndryshoi Vendimin e Konfirmimit, urdhëroi ZPS-në të dorëzonte një aktakuzë të konfirmuar të ndryshuar dhe caktoi datën për dorëzimin e mocioneve paraprake nga Mbrojtja.⁶
4. Më 16 prill 2025, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar (“Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar”).⁷
5. Më 8 maj 2025, Mbrojtja e z. Thaçi (“Mbrojtja e Thaçit”) dorëzoi, ndër të tjera, Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin (“Mocion”).⁸
6. Më 23 maj 2025, pas zgjatjes së afatit,⁹ ZPS-ja u përgjigj ndaj Mocionit (“Përgjigjja e ZPS-së”).¹⁰
7. Më 30 maj 2025, Mbrojtja e Thaçit u kundërpërgjigj (“Kundërpërgjigjja”).¹¹

⁶ KSC-BC-2023-12, F00260, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Amending the “Decision on the Confirmation of the Indictment” and Setting a Date for the Submission of Preliminary Motions](#) (Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake), 14 prill 2025, publik.

⁷ KSC-BC-2023-12, F00264, Prokurorja e Specializuar, [Submission of Amended Confirmed Indictment](#) (Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), 16 prill 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale (që përmban versionin konfidencial të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), dhe [Annex 2](#) (Shtojca 2), publike (që përmban versionin e redaktuar publik të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar).

⁸ KSC-BC-2023-12, F00290, Mbrojtja e Thaçit, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin*, 8 maj 2025, konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1 konfidenciale dhe *ex parte*. Versionet e redaktuara publike të parashtrimit kryesor dhe i shtojcës u dorëzuan më 12 maj 2025, F00290/RED and F00290/RED/A01/RED.

⁹ KSC-BC-2023-12, F00306, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje të Afatit në lidhje me Përgjigjet ndaj Mocioneve Paraprake*, 15 maj 2025, publik.

¹⁰ KSC-BC-2023-12, F00310, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit Paraprak të Thaçit në lidhje me Juridiksionin*, 23 maj 2025, konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 27 maj 2025, F00310/RED.

¹¹ KSC-BC-2023-12, F00318, Mbrojtja e Thaçit, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Përgjigjen e ZPS-së ndaj Mocionit Paraprak në lidhje me Juridiksionin*, 30 maj 2025, konfidenciale dhe *ex parte*.

II. PARASHTRIME

A. MOCIONI I MBROJTJES SË THAÇIT

8. Mbrojtja e Thaçit kundërshton juridiksionin e Gjykatës së Procedurës Paraprake për të shqyrtuar këtë çështje gjyqësore mbi bazën e dy pikave, konkretisht:

- (a) procesi aktual përfshihet në juridiksionin ekskluziv të Trupit Gjykues II – që ka në shqyrtim procesin paralel *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit* ("Çështja 06") nga ku buron çështja aktuale – dhe është nisur pa autorizimin e Trupit Gjykues II; dhe
- (b) Gjykatësja e Procedurës Paraprake u caktua në shkelje të Ligjit, pasi ishte caktuar më parë si Gjykatëse e Vetme në të njëjtën çështje, gjatë hetimit të akuzave që pretendohen aktualisht.¹²

9. Në lidhje me pikën e parë, Mbrojtja e Thaçit argumenton se: (i) në aktakuzën në çështjen aktuale bëhet fjalë për pretendime që kanë të bëjnë me Çështjen 06 dhe që lidhen thelbësisht me të; (ii) Trupi Gjykues II ka kompetencën mbi të gjitha aspektet që lidhen me Çështjen 06 dhe detyrimin për të garantuar që gjykimi të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procedurat ligjore të kryhen duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarit; (iii) Trupi Gjykues II nuk mund të përmbushë këtë detyrim në qoftë se një tjetër panel shqyrton aspektet që kanë të bëjnë me kryerjen e çështjes së vet; (iv) rrjedhimisht, Trupi Gjykues II duhet të ketë kompetencë dhe përgjegjësi ekskluzive për të gjitha aspektet e çështjes së vetë, përfshirë pretendime për mosbindje ndaj gjykatës dhe ndërhyrje ndaj dëshmitarëve; dhe (v) rrjedhimisht, duhej që Trupi Gjykues II të mbikëqyrte hetimin lidhur me veprat penale që pretendohen në çështjen

¹² Mocioni, para. 1-6.

aktuale, të vendoste nëse ato përlicojnë një aktakuzë dhe një çështje gjyqësore më vete, dhe të vendoste nëse një tjetër panel duhet të shqyrtojë atë.¹³ Në lidhje me këtë, Mbrojtja e Thaçit i referohet Rregullores së Provave dhe të Procedurës të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ") dhe parashtron se kjo duhet të shërbejë si orientim për procedurën në Dhomat e Specializuara.¹⁴

10. Mbrojtja e Thaçit shton se procesi aktual ka cenuar kompetencën e Trupit Gjyqësor II për të garantuar gjykim të drejtë në Çështjen 06 meqë: (i) Trupit Gjyqësor nuk iu dha mundësia të parandalonte dhe trajtonte pretendimet për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve; (ii) çdo vendim që merr Trupi Gjyqësor II në lidhje me dëshmitë që japin dëshmitarët në Çështjen 06– për të cilat ZPS-ja thotë se janë komprometuar – rrezikon shkelje të prezumimit të pafajësisë së z. Thaçi dhe paragjykim të rezultatit në çështjen aktuale; (iii) mundësia, koha dhe mjetet e z. Thaçi për të përgatitur mbrojtjen në Çështjen 06 ndikohen ndjeshëm nga procesi aktual; dhe (iv) Trupi Gjyqësor II nuk mund të garantojë të drejtat e z. Thaçi si i paraburgosur, sepse ai, në procesin aktual, është objekt i një tjetër standardi paraburgimi.¹⁵

11. Në lidhje me pikën e dytë, Mbrojtja e Thaçit argumenton se: (i) një gjykatës i vetëm mund të veprojë vetëm kur një çështje nuk është në shqyrtim nga një trup gjyqësor dhe Trupi Gjyqësor II ishte i caktuar tashmë dhe kompetent për të trajtuar pretendimet për ndërhyrje në Çështjen 06; (ii) Kryetarja i dha Gjykatës së Vetme mandat "të përhershëm" mbi aspekte hetimore, rol që nuk parashihet as në Ligj as në Rregullore, por në fakt parashohin se caktimi duhet të jetë i përkohshëm; dhe (iii) në të gjitha çështje gjyqësore, Kryetarja caktoi si Gjykatës të Procedurës Paraprake të dy gjykatësit që ishin caktuar si Gjykatës

¹³ Mocioni, para. 2-4, 21-45, 55-56, 83-85.

¹⁴ Mocioni, para. 30-41.

¹⁵ Mocioni, para. 46-54.

të Vetëm, në shkelje të nenit 33(1)(a) dhe (4) të Ligjit, që përcaktojnë se një gjykatës nuk mund të caktohet në role të njëpasnjëshme brenda të së njëjtës çështje.¹⁶ Për këto arsye, Mbrojtja e Thaçit parashtroi se Gjykatësja e Vetme dhe Gjykatësja e Procedurës Paraprake kanë vepruar *ultra vires* dhe se Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar është e pavlefshme për mungesë të juridiksionit dhe duhet të hidhet poshtë.¹⁷

B. PËRGJIGJJA E ZPS-SË

13. ZPS-ja parashtroi se Mocioni i Mbrojtjes së Thaçit duhet të hidhet poshtë në tërësi sepse keqpërdor procedurën e rregullës 97, nuk ka bazë ligjore dhe paraqet aspekte të papërshtatshme dhe të papranueshme.¹⁸

14. Më konkretisht, ZPS-ja së pari parashtroi se Mocioni nuk është kundërshtim ndaj juridiksionit brenda kuptimit të rregullës 97(1)(a) të Rregullores, por kundërshtim ndaj kompetencës dhe/ose ligjshmërisë për caktimin e gjykatësit (gjykatësve) të vetëm dhe gjykatësit (gjykatësve) të procedurës paraprake.¹⁹

15. Së dyti, në lidhje me pikën e parë të ngritur nga z. Thaçi, ZPS-ja parashtroi se: (i) pretendimi për juridiksion ekskluziv të Trupit Gjykses II bie ndesh me tekstin e qartë të Ligjit dhe Rregullores; (ii) vetëm ZPS-ja ka kompetencë për të kryer hetime dhe paraqitur aktakuza; (iii) për vepra penale sipas nenit 15(2), Ligji nuk përcakton një procedurë të ndryshme nga veprat penale që përfshihen në juridiksionin e Dhomave të Specializuara; (iv) Mbrojtja e Thaçit shpërfill dispozitat ligjore të Dhomave të Specializuara dhe në vend të tyre mbështetet në rregulla “të huaja” nga TPNJ-ja; (v) kompetenca e Trupit Gjykses II për të drejtuar procesin në Çështjen 06 nuk shtrihet edhe në procese të tjera, ku

¹⁶ Mocioni, para. 5, 57-81, 86.

¹⁷ Mocioni, para. 1, 6, 87-88.

¹⁸ Përgjigja e ZPS-së, para. 1-2, 37.

¹⁹ Përgjigja e ZPS-së, para. 3-4.

përfshihen të tjera akuza dhe të tjerë të akuzuar; (vi) neni 33(5) i Ligjit ndalon shprehimisht gjykatësit e Trupit Gjykses II nga proceset penale që rezultojnë nga shkeljet e nenit 15(2) të Ligjit; dhe (vii) pretendimet e Mbrojtjes së Thaçit se Trupi Gjykses II nuk është lejuar të zbatojë masat në përgjigje të shkeljeve të urdhrave të tij, se është cenuar ose anashkaluar kompetenca e tij, dhe se nuk mund të garantojë më gjykim të drejtë në Çështjen 06 janë pa bazë.²⁰

16. Së treti, në lidhje me pikën e dytë të ngritur nga z. Thaçi, ZPS-ja parashtron se: (i) Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka mandat të rishikojë vendimin e Kryetares për caktimin e Gjykatësit të Vetëm në KSC-BC-2018-01; (ii) një nga rastet kur caktimi i Gjykatësit të Vetëm është i përshtatshëm, është në kontekst të një hetimi para se të paraqiten akuzat, që ishte saktësisht rasti në fjalë; (iii) pretendimi i Mbrojtjes së Thaçit se caktimi i Gjykatësit të Vetëm u shndërrua në një “mandat të përhershëm” është i gabuar, i pavend, i pabazuar dhe i palogjikshëm; (iv) në qoftë se Mbrojtja e Thaçit dëshironte të kundërshtonte caktimin e Gjykatësit të Vetëm, asokohe edhe si Gjykatës i Procedurës Paraprake, duhej t’i kishte dorëzuar Kryetares një kërkesë për heqje sipas rregullës 20 të Rregullores; (v) sido që të jetë, caktimi i Gjykatës së Procedurës Paraprake përputhet me nenin 33(4) të Ligjit; dhe (vi) nuk ka arsye parimore për të veçuar Gjykatësen e Procedurës Paraprake nga aspektet mbi të cilat vendos Gjykatësi i Vetëm.²¹

C. KUNDËRPËRGJIGJJA E MBROJTJES SË THAÇIT

17. Në Kundërpërgjigje, Mbrojtja e Thaçit përsërit shumë prej argumenteve të ngritura në Mocion²² dhe parashtron po ashtu se mocionet paraprake në lidhje

²⁰ Përgjigjja e ZPS-së, para. 5-17.

²¹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 18-37.

²² *Shih* Kundërpërgjigjen, para. 1, 9-26.

me juridiksionin sipas rregullës 97(1)(a) të Rregullores përfshijnë aspekte të juridiksionit të një paneli konkret të Dhomave të Specializuara.²³

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

18. Sipas nenit 39(1) të Ligjit, gjykatësi i procedurës paraprake ka kompetencë për të marrë vendim në lidhje me çdo mocion paraprak dhe për të lëshuar urdhrat apo vendimet e nevojshme për të siguruar që çështja të përgatitet siç duhet dhe në mënyrë të shpejtë për gjykim.

19. Sipas rregullës 95(2)(f) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake, ndër të tjera, vendos në lidhje me mocionet paraprake të dorëzuara sipas rregullës 97 të Rregullores, para se dosja e çështjes gjyqësore t'i kalohet trupit gjykues.

20. Sipas rregullës 97(1) të Rregullores, i akuzuari mund t'i paraqesë mocione paraprake gjykatësit të procedurës paraprake në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit, të cilat: (a) nuk njohin juridiksionin e Dhomave të Specializuara; (b) pretendojnë mangësi në formën e aktakuzës, ose (c) kërkojnë veçimin e akuzave.

IV. DISKUTIM

A. LLOJI I KUNDËRSHTIMEVE TË MBROJTJES SË THAÇIT

21. Përpara se të trajtojë themelësinë e Mocionit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e gjykon të domosdoshme të përcaktojë llojin e kundërshtimeve të ngritura nga Mbrojtja e Thaçit. Mbrojtja e Thaçit ka paraqitur Mocionin e vet si kundërshtim ndaj juridiksionit të Dhomave të Specializuara sipas rregullës 97(1)(a) të Rregullores.²⁴

²³ Kundërpërgjigja, para. 4-8.

²⁴ *Shih* Mocionin, para. 1.

22. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se në mënyrë që një aspekt të përfshihet në elementin juridiksional të rregullës 97(1) të Rregullores, ai duhet të lidhet me njërën prej pikave të juridiksionit të përcaktuara në nenet 6 deri 9 të Ligjit, ku shtjellohet baza tradicionale e juridiksionit: lëndor, kohor, territorial dhe personal.²⁵ Z. Thaçi nuk po e kundërshton juridiksionin e Dhomave të Specializuara siç parashihet në nenet 6 deri në 9 të Ligjit. Përkundrazi, ai po kundërshton kompetencën e Gjykatësës së Procedurës Paraprake për të shqyrtuar çështjen aktuale. Si rezultat, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk do të trajtojë kundërshtimet e z. Thaçi në kuadër të rregullës 97(1)(a) të Rregullores.

23. Megjithatë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se sipas nenit 39(1) të Ligjit mocionet paraprake nuk kufizohen vetëm në ato të përcaktuara shprehimisht në rregullën 97(1) të Rregullores, por përcakton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka kompetencë për të vendosur për “çdo mocion paraprak” (theksimi i shtuar).²⁶ Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të shqyrtojë Mocionin e z. Thaçi në lidhje me kompetencën e saj sipas nenit 39(1) të Ligjit.

²⁵ Shih Vendimin e Konfirmimit, para. 39. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00450, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision on Motions Challenging the Legality of the SC and SPO and Alleging Violations of Certain Constitutional Rights of the Accused](#) (Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve) (“Vendimi mbi Mocionet që Kundërshtojnë Ligjshmërinë në Çështjen 06”), 31 gusht 2021, publik, para. 54. Shih gjithashtu KSC-BC-2023-10, F00433/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Preliminary Motions and Related Requests](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionet Paraprake dhe Kërkesat në Lidhje me Të) (“Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 10”), 12 gusht 2024, publik, para. 34.

²⁶ Shih [Case 06 Decision on Motions Challenging Legality](#) (“Vendimi mbi Mocionet që Kundërshtojnë Ligjshmërinë në Çështjen 06”), para. 54-55; [Case 10 Decision on Preliminary Motions](#) (Vendimi mbi Mocionet Paraprake në Çështjen 10), para. 36.

B. PIKA E PARË: NËSE ASPEKTI AKTUAL DUHEJ TË ISHTE PARAQITUR PARA TRUPIT
GJYKUES II

24. Gjykatësja e Procedurës Paraprake së pari do të përcaktojë kornizën ligjore që rregullon kompetencat dhe përgjegjësitë e ZPS-së, Gjykatësës së Procedurës Paraprake dhe të Trupit Gjykues gjatë fazave të ndryshme të procesit, në raport me të cilin ajo më pas do të trajtojë argumentet e Mbrotjtjes së Thaçit.

25. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se sipas nenit 35(1) të Ligjit, ZPS-ja është përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës për krime që përfshihen në juridiksionin Dhomat e Specializuara. Nenet 35(2) dhe 38(1) të Ligjit e përforcojnë këtë përgjegjësi, duke përcaktuar se Prokurori i Specializuar dhe prokurorë të tjerë në kuadër të ZPS-së kanë kompetencë dhe autoritet të kryejnë hetime penale dhe të marrin përgjegjësi për hetime penale apo procedura gjyqësore të reja në kuadër të juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara. Çka është më me rëndësi për këtë vendim, neni 35(2)(g) dhe (i) i Ligjit deklaron se ZPS-ja ka kompetencën dhe përgjegjësinë për të marrë vendime për fillimin, vazhdimin ose pushimin e procedurës penale dhe paraqitjen e aktakuzave dhe procedimin e tyre nëpër të gjitha fazat. I njëjti parim pasqyrohet dhe në nenin 38(4) të Ligjit dhe rregullën 86(1) dhe (2) të Rregullores, që trajtojnë paraqitjen e një aktakuze. Pas paraqitjes së një aktakuze dhe para se të konfirmohen akuzat, ZPS-ja mund të ndryshojë aktakuzën ose ta tërheqë pa lejen e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, në pajtim me nenet 39(8) dhe 40(7) të Ligjit dhe rregullat 90(1)(a) dhe 91(1)(a) të Rregullores.

26. Dispozitat e lartpërmendura tregojnë se sipas kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara, ZPS-ja është i vetmi subjekt i cili ka kompetencën për të kryer

hetime, paraqitur aktakuza dhe nisur procedime penale.²⁷ Ligji dhe Rregullorja nuk u japin kompetencë të tillë subjekteve ose organeve të tjera. Ky interpretim përforcohet nga fakti që para se të konfirmohen akuzat, ZPS-ja mund të ndryshojë aktakuzën ose ta tërheqë plotësisht pa lejen e gjykatësit të procedurës paraprake. Megjithëse Ligji dhe Rregullorja parashohin mbikëqyrje gjyqësore në disa rrethana (sikurse për konfirmimin e akuzave),²⁸ vendimi nëse duhet paraqitur aktakuza – dhe bashkë me të, nisur procedimi penal – është e drejtë e ZPS-së.

27. Pasi ZPS-ja paraqet një aktakuzë, neni 39(1) dhe (2) i Ligjit dhe rregulla 86 e Rregullores përcaktojnë se gjykatësi i procedurës paraprake ka kompetencën për të shqyrtuar aktakuzën në fjalë dhe për të konfirmuar ose rrëzuar akuzat plotësisht ose pjesërisht. Më tej, pas konfirmimit të akuzave dhe para se çështja t'i caktohet një trupi gjykues, ZPS-ja mund të ndryshojë aktakuzën ose ta tërheqë pa leje të gjykatësit të procedurës paraprake, në përputhje me nenet 39(8) dhe 40(7) të Ligjit dhe rregullat 90(1)(b) dhe 91(1)(b) të Rregullores.

28. Dispozitat e lartpërmendura tregojnë se, pas paraqitjes së aktakuzës, kompetenca e ZPS-së për të proceduar me faza të mëtejshme të procesit varet vetëm nga mbikëqyrja e gjykatësit të procedurës paraprake. Gjykatësi i procedurës paraprake është i vetmi subjekt që sipas kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara, në këtë fazë, ka kompetencën të shqyrtojë aktakuzën dhe të konfirmojë ose rrëzojë akuzat.²⁹ Ky interpretim nuk ndikohet nga formulimi i nenit 40(6)(a) të Ligjit, që i lejon një trupi gjykues të ushtrojë kompetencat e

²⁷ *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, F00010, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Order to the Specialist Prosecutor Pursuant to Rule 86\(4\) of the Rules](#) (Urdhër Prokurorit të Specializuar në Pajtim me Rregullën 86(4) të Rregullores), 2 korrik 2020, publik, para. 8, 10.

²⁸ *Shih* nenin 39(1)-(2) të Ligjit; *shih gjithashtu, për shembull*, rregullat 31-41 dhe 86 të Rregullores.

²⁹ Pasi çështja t'i caktohet një trupi gjykues, ZPS-ja mund të ndryshojë aktakuzën ose të tërheqë atë me leje të trupit gjykues, sikurse përcaktohet në nenet 39(8) dhe 40(7) të Ligjit dhe rregullave 90(1)(c) dhe 91(1)(c) të Rregullores. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se kompetenca e trupit gjykues vlen vetëm për ndryshimin ose tërheqjen e një aktakuze ekzistuese, jo për konfirmimin e një aktakuze krejtësisht të re.

gjykatësit të procedurës paraprake, sipas nevojës, ose nga neni 40(7) i Ligjit dhe rregullat 90(1)(c) dhe 91(1)(c) të Rregullores, sepse as Ligji as Rregullorja nuk parashohin që një trup gjykues të ketë rol në fazën paraprake të procesit.

29. Në fakt, sipas nenit 40(1) të Ligjit, trupi gjykues është përgjegjës “për zhvillimin e procedurës së *shqyrtimit gjyqësor*” (theksimi i shtuar). Përgjegjësitë e një trupi gjykues në lidhje me këtë krijohen vetëm pasi të dalin vendimet në lidhje me mocione paraprake, pasi ZPS-ja dhe Mbrojtja – nëse dëshirojnë – dorëzojnë dosjet paraprake dhe listën e dëshmitarëve të tyre dhe gjykatësi i procedurës paraprake ia kalon çështjen trupit gjykues, sikurse parashihet në rregullat 72(1) dhe 98(1) të Rregullores. Megjithëse një trup gjykues ka kompetencë të gjerë për të miratuar masa dhe procedura që mund të jenë të domosdoshme për garantimin e kryerjes së shpejtë dhe të drejtë të gjykimit, këto kompetenca përfshijnë vetëm kryerjen e *fazës së gjykimit*.³⁰ Gjithashtu, trupi gjykues mund të kryejë vetëm funksionet e tij dhe të ushtrojë kompetencat e tij në procesin (gjyqësor) në të cilin është caktuar. Ai nuk mund të shtrijë kompetencat e tij në procese të tjera (të reja) në të cilat nuk është i caktuar.

30. Duke iu kthyer argumenteve të Mbrojtjes së Thaçit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk bindet nga to për arsyet në vijim.

31. Së pari, argumenti i Mbrojtjes së Thaçit se ZPS-ja duhej t’i kishte paraqitur Trupit Gjykues II aspektin e tentimit të pretenduar nga i akuzuari për ndërhyrje në procesin e Çështjes 06 për të vendosur nëse përligjet lëshimi i aktakuzës dhe një çështjeje gjyqësore më vete, janë të gabuara. Sikurse shtjellohet më lart, dorëzimi i një aktakuze dhe nisja e procedimit kundër një të dyshuari është e drejtë (ekskluzive) e ZPS-së dhe varet vetëm nga mbikëqyrja e gjykatësit të

³⁰ *Shih, për shembull*, KSC-BC-2020-05, F00114, Kryetarja, [Decision Assigning Trial Panel I](#) (Vendim për Caktimin e Trupit Gjykues I), 5 maj 2021, publik, para. 4; KSC-BC-2020-06, F01132, Kryetarja, [Decision Assigning Trial Panel II](#) (Vendim për Caktimin e Trupit Gjykues II), 30 nëntor 2022, publik, para. 4: ku thuhet: “Kryetarja me këtë vendim cakton Trupin Gjykues II [...] për këtë çështje gjyqësore, pas dorëzimit të dosjes gjyqësore”.

procedurës paraprake në kontekst të konfirmimit të akuzave. As Ligji as Rregullorja nuk i japin një trupi gjykues kompetencë për të udhëzuar (apo jo) ZPS-në që t'i paraqesë një gjykatësi të procedurës paraprake një aktakuzë të re.

32. Së dyti, sikurse u përmend më lart, kompetenca e një trupi gjykues mbi një gjykim dhe përgjegjësia e tij për të garantuar kryerje të drejtë dhe të shpejtë të procesit nuk shtrihet *përtej* çështjes për të cilën është caktuar. Duket se Mbrojtja e Thaçit e pranon këtë,³¹ por arrin në përfundime të gabuara.³² Sikurse edhe çdo çështje që lidhet me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, dhe kjo çështje lidhet me procese zyrtare para Dhomave të Specializuara, konkretisht procesi në Çështjen 06. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se çështja aktuale, dhe Çështja 06 janë “e njëjta çështje”. Konkretisht, në to përfshihen persona të akuzuar të ndryshëm, vepra penale të pretenduara të ndryshme dhe çështjet kanë shtrirje kohore të ndryshme. Mbrojtja e Thaçit nuk i kushton rëndësinë e duhur këtij aspekti.³³ Kompetenca e Trupit Gjykses II për procesin në Çështjen 06, nuk mund të përlligjë shtrirjen e kompetencave të tij në procesin e një çështjeje gjyqësore tjetër (në këtë rast, kjo çështje). Po të ndodhte, kjo do të cenonte kompetencat dhe përgjegjësitë e ZPS-së dhe të Gjykatës së Procedurës Paraprake, të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore. Përgjegjësia e trupit gjykses për të garantuar njëkohësisht drejtësinë e procesit dhe të drejtat e të akuzuarve nuk i jep atij të drejtë të vendosë nëse veprat penale kundër administrimit të

³¹ *Shih* Mocionin, para. 22 (“Sipas nenit 40 të Ligjit të DHS-së, një trup gjykses është përgjegjës për të gjitha vendimet e shkallës së parë në lidhje me çështjet të cilat i shqyrton ai. Kompetencat e trupit gjykses sipas nenit 40 janë gjithëpërfshirëse dhe ekskluzive Kur paneli ngarkohet me shqyrtimin, Ligji i DHSK-së i jep atij autoritet të plotë mbi të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me çështjen. Ligji i DHSK-së nuk parashikon *asnjë* panel tjetër të veproje në lidhje me çështjen (përveç atyre në apel me vendim të një trupi gjykses). Kjo bëhet e qartë nga disa burime” (theksimi në original)).

³² Jurisprudenca e GJPN-së që paraqet Mbrojtja e Thaçit për të mbështetur qëndrimin e vet se Trupi Gjykses II ka autoritet ekskluziv “mbi procesin” tregon se Dhomat Gjyqësore në fakt kanë kompetencë vetëm për aspektet që *përfshihen* në çështjet për të cilat janë caktuar ata, e jo në procese gjyqësore të tjera. *Shih* Mocionin, poshtëshënimet 34-38.

³³ *Shih gjithashtu* KSC-BC-2023-12, INV/F00243, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi Kompetencën e Gjykatës së Vetme për të Vendosur në lidhje me Kërkesën e ZPS-së F00739* (“Vendimi mbi Kompetencën e Gjykatës së Vetme”), 24 janar 2025, konfidencial, para. 14.

drejtësisë – ku përfshihen katër persona të tjerë që nuk janë të akuzuar në Çështjen 06 – do të ndiqen penalisht nga ZPS-ja, apo jo. Po të ndodhte kjo, gjykatësit në fakt do të shqyrtonin një aspekt të nenit 15(2) që ka rezultuar nga procesi në shqyrtim prej tyre, në kundërshtim me nenin 33(5) të Ligjit. Po kështu, argumenti që vetëm Trupi Gjykses II duhej të kishte përdorur masat sipas rregullës 65 të Rregullores,³⁴ ose duhej të kishte pasur përgjegjësinë për të autorizuar masat hetimore,³⁵ kufizon funksionet dhe kompetencat e ZPS-së dhe të Dhomave të Specializuara në mënyrë të papërligjur dhe të padrejtë dhe cenon përgjithësisht mandatin e tyre për ndjekje penale efektive të pretendimeve për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.³⁶ Argumenti i Mbrojtjes së Thaçit është thjesht një *non sequitur*.

33. Së treti, parashtrimi i Mbrojtjes së Thaçit se tekstet juridike të Dhomave të Specializuara nuk sqarojnë se si duhet të trajtohen pretendimet për mosbindje ndaj gjykatës ose ndërhyrje ndaj dëshmitarëve që rezultojnë nga proceset para Dhomave të Specializuara, është gjithashtu i gabuar. Nenet 15(2) dhe 16(3) të Ligjit përcaktojnë qartë se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi veprat penale kundër administrimit të drejtësisë kur ato lidhen me procese zyrtare dhe zyrtarë të saj dhe se personat kanë përgjegjësi penale për këto vepra penale. Neni 33(5) i Ligjit pasqyron të njëjtin parim kur flet për procese penale që rezultojnë nga shkelje të nenit 15(2) të Ligjit që burojnë nga një çështje tashmë para Dhomave të Specializuara. Këto procese sipas nenit 15(2) më pas ndjekin të njëjtin proces dhe procedurë, si çdo çështje tjetër para Dhomave të Specializuara, që janë të përcaktuara qartë në nenet 38(4), 39(1) dhe (2) dhe 40(1) të Ligjit, ndër të tjera. Nuk ka zbrazëti ligjore në Ligj ose Rregullore në lidhje me këtë, dhe mbështetja prej Mbrojtjes së Thaçit në Rregulloren e Procedurës

³⁴ *Shih* Mocionin, para. 29, 42, 47.

³⁵ *Shih* Mocionin, para. 42.

³⁶ *Shih gjithashtu* para. 37 më poshtë.

dhe të Provave para TPNJ-së, Udhëzuesit e Punës të TPNJ-së, ose mendime individuale të gjykatësve të TPNJ-së, është e pavend.

34. Së fundi, por po aq e rëndësishme, argumenti i Mbrojtjes së Thaçit se Trupi Gjykses II nuk është më në gjendje të garantojë të drejtat për gjykim të drejtë të z. Thaçi dhe se janë cenuar të drejtat e tij nuk është bindës për arsyet në vijim: (i) fakti që Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka në shqyrtim çështjen aktuale nuk cenon aftësinë e Trupi Gjykses II për të garantuar të drejtat e z. Thaçi për gjykim të drejtë në Çështjen 06, sepse ky Grup Gjykses vazhdon të ketë kontroll të plotë mbi procesin në Çështjen 06;³⁷ (ii) si Trupi Gjykses II ashtu dhe Gjykatësja e Procedurës Paraprake kanë detyrimin të mbrojnë të drejtat e z. Thaçi sipas kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara, brenda kontekstit të proceseve përkatëse të tyre;³⁸ (iii) Mbrojtja e Thaçit ngre argumente që janë trajtuar tashmë (në lidhje me kohën dhe mjetet e z. Thaçi për përgatitje të mbrojtjes dhe me dy kushte më vete të paraburgimit të vendosura për të);³⁹ dhe (iv) parashtrimi i Mbrojtjes së Thaçit se të drejtat e z. Thaçi për gjykim të drejtë janë ndikuar është i pabazë, sepse asnjë nga shembujt e paraqitur nuk tregojnë se ka ndodhur kjo. Hamendësimi i Mbrojtjes së Thaçit se konstatimet e Trupit Gjykses II në Çështjen 06 do të bëhen *res judicata* dhe e bëjnë procesin aktual të tejkaluar⁴⁰ shpërfill faktin se çdo konstatim në lidhje me akuzat në të dy çështjet janë krejtësisht të ndryshme dhe panelet i kryejnë procedurat (dhe vlerësimet) e tyre në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. Konkretisht, Trupi Gjykses II do të

³⁷ Shih Vendimin mbi Kompetencën e Gjykatës së Vetme, para. 14.

³⁸ Ngjashëm, Vendimi mbi Kompetencën e Gjykatës së Vetme, para. 14. Mbrojtja e Thaçit ka në dispozicion mjete juridike për këtë çështje dhe Çështjen 06 (për shembull, duke kërkuar pezullim të procesit në Çështjen 06).

³⁹ Shih Mocionin, para. 51-55; KSC-BC-2023-12, F00135, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Thaçi Defence Request for Variation of the Time Limit for Preliminary Motions](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Afateve për Parashtrimin e Mocioneve Paraprake), 24 janar 2025, publik, para. 19; F00165, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Review of Detention of Hashim Thaçi](#) (Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit), 7 shkurt 2025, publik, para. 21.

⁴⁰ Mocioni, para. 48.

kryejë vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve në Çështjen 06 dhe do të vendosë vetë në lidhje me ndikimin e ndërhyrjes (së tentuar) të pretenduar dhe bazuar në provat e administruara prej tij.

35. Për të gjitha këto arsye, Gjykatësja e Procedurës Paraprake hedh poshtë pikën e parë të ngritur nga z. Thaçi.

C. NËSE GJYKATËSJA E VETME DHE GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE U CAKTUAN NË SHKELJE TË LIGJIT

36. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton argumentet e Mbrojtjes së Thaçit se Gjykatësja e Vetme dhe Gjykatësja e Procedurës Paraprake u caktuan në shkelje të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara, meqë: (i) Trupi Gjykues II ishte caktuar tashmë për të shqyrtuar pretendime në lidhje me ndërhyrje (të tentuar) ndaj dëshmitarëve në Çështjen 06; (ii) Kryetarja caktoi një Gjykatës të Vetëm “të përhershëm”, rol që nuk parasheh as Ligji as Rregullorja; dhe (iii) Kryetarja caktoi si Gjykatëse të Procedurës Paraprake të njëjtën gjykatëse që ishte caktuar si Gjykatëse e Vetme për hetimin mbi pretendimet që çuan në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar.⁴¹

37. Së pari, sa i përket pretendimit të Mbrojtjes së Thaçit se Trupi Gjykues II ishte caktuar për të mbikëqyrur hetimin në lidhje me pretendime për ndërhyrje (të tentuar) ndaj dëshmitarëve,⁴² Gjykatësja e Procedurës Paraprake u referohet konstatimeve më sipër se ky qëndrim kufizon në mënyrë të tepruar dhe të papërshtatshme funksionin dhe kompetencat e ZPS-së dhe të Dhomave të Specializuara.⁴³ Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit,⁴⁴ ZPS-ja pati të drejtë që iu drejtua Gjykatëses së Vetme, e caktuar “për shqyrtimin e

⁴¹ Mocioni, para. 57-81.

⁴² *Shih* Mocionin, para. 62, 69.

⁴³ *Shih* para. 32 më lart.

⁴⁴ Mocioni, para. 63.

çfarëdo kërkesë për autorizim gjyqësor dhe çështje të lidhura me to, parashtruar nga Prokurori i Specializuar para ngritjes së aktakuzës”.⁴⁵

38. Së dyti, caktimi i gjykatësve përfshihet plotësisht në kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryetares sipas nenit 33 të Ligjit. Sa i përket kundërshtimit të Mbrojtjes së Thaçit lidhur me vlefshmërinë e caktimit të Gjykatës së Vetme (qoftë si Gjykatëse e “përhershme” apo jo),⁴⁶ Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka kompetencën të japë mendim për këtë aspekt, sepse kjo do të nënkuptonte që ajo të gjykojë vendimin e Kryetares në lidhje me këtë.

39. Së treti, parashtrimi i Mbrojtjes së Thaçit se caktimi i të njëjtës gjykatëse si Gjykatëse e Vetme dhe Gjykatëse e Procedurës Paraprake ishte i palejueshëm, përfshihet plotësisht në rregullën 20 të Rregullores në lidhje me “Vetëtërheqjen ose Heqjen e gjykatësve”. Në qoftë se Mbrojtja e Thaçit ka menduar se kishte arsye për heqjen e Gjykatës së Vetme/Gjykatës së Procedurës Paraprake, këtë aspekt ka mundur dhe duhej ta kishte ngritur sipas procedurës së përcaktuar në rregullën 20(3) të Rregullores.⁴⁷ Megjithatë, nuk e bëri këtë. Mbrojtja e Thaçit nuk mund të anashkalojë këtë procedurë dhe afatet në fuqi duke ngritur këtë aspekt tani, në kontekst të një mocioni paraprak.

40. Së fundi, jashtë këtij argumenti procedural, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojtja e Thaçit bën parashtrime të përgjithshme dhe pa bazë në kontekst abstrakt dhe nuk arrin të vërtetojë konkretisht si caktimi i

⁴⁵ Shih KSCPR-2018, F00004, Kryetarja, [Decision Assigning a Single Judge Pursuant to Article 33\(2\) of the Law](#) (Vendim për Caktimin e një Gjykatësi të Vetëm sipas Nenit 33(2) të Ligjit), 29 maj 2018, publik, para. 16 dhe Vendimi. Theksohet se e nënshkruara u caktua si Gjykatëse e Vetme në “procesin aktual” më 6 qershor 2024, pas Gjykatësit Nikola Giju, me mandat që nuk kufizohej në asnjë kërkesë ose çështje konkrete; shih KSC-BC-2018-01, F00697, Kryetarja, *Vendim mbi Caktimin e Gjykatës së Vetme*, 6 qershor 2024, publik. Në kundërshtim me parashtrimin e Mbrojtjes së Thaçit në Mocion, para. 63, juridiksioni i Gjykatës së Vetme buron nga vendimi i Kryetares për caktimin, brenda kornizës së Ligjit, jo nga një kërkesë e ZPS-së.

⁴⁶ Mocioni, para. 57, 65-69, 82, 87-88; *por shih* Kundërpërgjigjen, para. 17.

⁴⁷ Rregulla 20(3) e Rregullores përcakton se një palë mund t'i paraqesë Kryetarit kërkesë për heqjen e menjëhershme të një gjykatësi, por jo më vonë se dhjetë (10) ditë pasi pala në fjalë të ketë marrë dijeni për arsyet mbi të cilat mbështet kërkesën për heqjen e atij gjykatësi.

saj si Gjykatëse e Vetme dhe e Procedurës Paraprake mund të kishte ndikuar ose duket se ka ndikuar në paanësinë e saj. Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se si Gjykatëse e Vetme ajo ishte caktuar të shqyrtonte kërkesat për autorizim gjyqësor dhe çështje të lidhura me to, të paraqitura nga ZPS-ja para dorëzimit të aktakuzës. Roli i saj si Gjykatëse e vetme ishte dhe është i përkufizuar rreptësisht. Po ashtu, si Gjykatëse e Procedurës Paraprake, roli i saj nuk është “për të shërbyer si [...] kontroll” në lidhje me aspekte hetimore të nisura para se të caktohej ajo, as për të “sjellë një perspektivë të re në proces”, sikurse pretendon Mbrojtja e Thaçit,⁴⁸ por për të shqyrtuar aktakuzën dhe përgatitur çështjen për gjykim. Argumentet e Mbrojtjes së Thaçit janë gjithashtu kundërthënëse dhe të pasinqerta kur argumentojnë se përfshirja e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në aspekte hetimore si Gjykatëse e Vetme ka ndikuar në paanësinë e saj, ndërsa paanësia e gjykatësve të Trupit Gjykues II nuk do të ndikohej. Gjithashtu, parashtimi i Mbrojtjes së Thaçit se Gjykatësja e Procedurës Paraprake, si Gjykatëse e Vetme pati qasje në dokumente që nuk janë pjesë e çështjes aktuale dhe Mbrojtja nuk ka qasje në to, është i gabuar, sepse: (i) Vendimi i Konfirmimit bazohet ekskluzivisht në materialin dhe parashtimet e ZPS-së në procesin aktual, që janë nxjerrë për Mbrojtjen dhe janë në dispozicion të saj; (ii) pas konfirmimit të aktakuzës, kërkesat për masa hetimore që lidhen rreptësisht me çështjen aktuale, Gjykatësja e Vetme i ka transferuar në procesin aktual⁴⁹ dhe kërkesat e

⁴⁸ Mocioni, para. 74, 77-78.

⁴⁹ Vendimi mbi Kompetencën e Gjykatësës së Vetme, para. 17-18. Vlen të theksohet se i vetmi shembull konkret që dha Mbrojtja e Thaçit nuk mbështet parashtimin e vet, meqë ka të bëjë me një kërkesë mbi të cilën Gjykatësja e Vetme nuk ka vendosur para konfirmimit të aktakuzës, por vendosi Gjykatësja e Procedurës Paraprake pas konfirmimit. Gjithashtu, edhe në qoftë se parashtimet e Thaçit qëndrojnë – çka nuk është rasti këtu – Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, në fakt në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje, një numër i madh i masave hetimore të autorizuar para konfirmimit të aktakuzës u autorizuan nga Gjykatësi i Vetëm i caktuar më parë. Rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes së Thaçit nuk vlejnë as për rrethanat e kësaj çështjeje. Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake prandaj nuk konstaton se është shkaktuar dëm.

reja do të trajtohen nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake;⁵⁰ dhe (iii) parashtrimet e protokolluara dhe vendimet përkatëse të lëshuara në kuadër të dosjes hetimore që kanë të bëjnë me të akuzuarin janë kopjuar dhe transferuar në dokumentacionin e çështjes aktuale.⁵¹

41. Për arsyet e lartpërmendura, pika e dytë e ngritur nga Mbrojtja e Thaçit hidhet poshtë.

V. VENDIM

42. Bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- a. **HEDH POSHTË** Mocionin Mbrojtjes së Thaçit;
- b. **RIKUJTON** se procedura e paraparë në nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 77 të Rregullores vlen për vendimin aktual; dhe
- c. **URDHËRON** Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kundërpërgjigjes së saj (F00318), ose të kërkojë riklasifikimin si publik, jo më vonë se të **enjten, 26 qershor 2025**.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhor Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E enjte, 19 qershor 2025

Hagë, Holandë.

⁵⁰ KSC-BC-2023-12, INV/F00003, Gjykatësja e Vetme, [Order for Transfer of Documents](#) (Urdhër për Transferimin e Dokumenteve), ("Urdhri për Transferimin"), 27 janar 2025, publik, para. 14(i).

⁵¹ [Order for Transfer](#) (Urdhri për Transferimin), para. 5-6.